

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË E TIRANËS PËR PROJEKTIN
“NDËRTIMI I RRUGËVE BASHKIAKE TË TIRANËS”

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë e Tiranës, për projektin “Zhvillimi i rrugëve Bashkiake të Tiranës”, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga fillimi i projektit deri 30.09.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 26 datë 31.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 855/7 datë 31.03.2014, dërguar Z. Lulzim Basha, Kryetar i Bashkisë Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Bashkia Tiranë të marrë masat e nevojshme për përfundimin në afatet e parashikuara në marrëveshje të projekteve me financime të huaja, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm nga Njësia e Zbatimit të Projektit, me qëllim për të shmangur rritjen e kostove financiare, si dhe sigurimin e maksimumit të përfitimeve.

Vazhdimisht

2. Njësia e Zbatimit të Projekteve t’i përmbahet me rigorozitet raportimeve, hapjes së llogarive krahas asaj kryesore, si dhe afateve të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit, për të pasur ecuri normale të zbatimit të tyre.

Vazhdimisht

3. Bashkia Tiranë dhe Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrin masa për të përgatitur në afat dhe sipas kërkesave të marrëveshjeve, projektet e vendimeve për Këshillin Bashkiak të Tiranës, të programeve, strategjive dhe të gjithë dokumentacionit tjetër, për të arritur efektivitetin e pritur nga projektet me investime të huaja.

Vazhdimisht

4. Njësia e Zbatimit të Projekteve gjatë veprimtarisë saj, të marrë masat e nevojshme që dokumentacionet e veçanta të projekteve si: Plani i menaxhimit mjedisor, Plan-veprimi social etj., të përgatiten nga specialistë të licencuar për fushën përkatëse.

Vazhdimisht

5. Njësia e Zbatimit të Projekteve të raportojë pranë donatorëve sipas llojit të dokumenteve dhe afatit të përcaktuar në marrëveshjet e ndryshme, në funksion të maksimizimit të efektivitetit të projekteve me financime të huaja.

Vazhdimisht

6. Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrë masa për të gjithë dokumentacionin e përgatitur prej saj dhe/ose nga individë dhe subjekte që kryejnë shërbime sipas aktiviteteve të projekteve që të jenë të rregullt nga ana e plotësimit formal të tyre në lidhje me datën, përgatitësin, pranimin, cilësinë e tyre etj.

Vazhdimisht

7. Bashkia Tiranë dhe Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrë masa për zbatimin e legjislacionit shqiptar për ndërtimet, lidhur me marrjen e lejeve të ndërtimit, aktin e kolaudit dhe lejë e shfrytëzimit të objektit.

Vazhdimisht

8. Bashkia Tiranë dhe Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrin masat e nevojshme për të siguruar nivelin dhe ritmin e programuar të disbursimeve në funksion jo vetëm të realizimit në afat të projektit, por edhe për të shmangur kostot subjektive nga pagesa e tarifës së angazhimit.

Vazhdimisht

9. Bashkia Tiranë dhe Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrë masat e nevojshme për kuadrimin në bilancin kontabël të vitit 2013 të AQT në zërin “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,004,084.2 mijë lekë, investimi për rrugët që janë ende në proces ndërtimi, vlerë e cila nuk kuadron me inventarin fizik të objekteve të përfunduara.

Brenda tremujorit të parë 2014

10. Bashkia Tiranë të marrë masat e nevojshme për të miratuar në këshillin bashkiak buxhetet vjetore të detajuara për financimin e shpenzimeve operative për Njësinë e Zbatimit të Projekteve me financime të huaja.

Menjëherë

11. Njësia e Zbatimit të Projekteve të përcaktojë rregulla dhe procedura të qarta për menaxhimin e aktiveve (përfshirë dhe shpenzimet për karburant), si dhe ndarje të funksioneve për stafin në përputhje me ligjin nr 10296, datë 8.01.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe të zbatohen rregullat për shpenzimet buxhetore në veprimet e pagesave me bankë për shpenzimet operative.

Menjëherë

12. Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrë masat e nevojshme për të mbajtur dhe arkëtuar në organet tatimore detyrimin që u lind subjekteve të huaja që ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin fiskal për tatimin në burim.

Vazhdimisht

13. Njësia e Zbatimit të Projekteve dhe Bashkia Tiranë, të marrë masat e nevojshme për pagesën e detyrimeve për kredinë në shumën 1,534,860 euro, si dhe të tarifës së angazhimit për të shmangur rritjen e kostonë së projektit nga penalizimet për mos përmbushje të detyrimeve të marrëveshjes së nënhuasë.

Menjëherë

14. Njësia e Zbatimit të Projekteve dhe Bashkia Tiranë, të marrë masa për dorëzimin e dokumentacionit tekniko ligjor të objekteve, që do t'i lihet në përdorim Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, deri në momentin e kalimit të tyre me Vendimin e

Këshillit Bashkiak si mjete themelore në atë ndërmarrje, në zbatim të Urdhrit të brendshëm nr. 1473, datë 26.11.2008, pika 3.

Menjëherë

15. Njësia e Zbatimit të Projekteve dhe Bashkia Tiranë, të marrin masa që anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim të veprave të përfunduara të punimeve civile të zotërojnë licencat përkatëse për kolaudim, si dhe para fillimit të punimeve të sigurohet dokumentacioni i nevojshëm ligjor lidhur me lejet e ndërtimit, lejet për shesh ndërtimi dhe aktkolaudimet.

Vazhdimisht

16. Njësia e Zbatimit të Projekteve dhe Bashkia Tiranë, të marrin masat e nevojshme që të zbatojnë me përpikëri rregullat dhe politikat e donatorit të përcaktuara në marrëveshje lidhur me planin e prokurimeve, procedurat dhe zbatimin e kontratave.

Vazhdimisht

17. Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrë masat e nevojshme për monitorimin e vazhdueshëm për zbatimin në afat të kontratave, për strukturën, përmbajtjen, miratimin dhe pagesat e raporteve të shërbimeve të konsulencës, në përputhje me termat e referencës.

Vazhdimisht

18. Njësia e Zbatimit të Projekteve dhe Bashkia Tiranë, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e ligjit shqiptar në rastin e prokurimeve publike të përcaktuara sipas kësaj forme, lidhur me krijimin e Njesisë së Prokurimit, Komisionit të Vlerësimit të ofertave, kushteve, afateve dhe dokumentacionit përkatës.

Menjëherë

19. Bashkia Tiranë dhe Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrin masat e nevojshme për likuidimin e detyrimit të TVSH-së në shumën 1,005,750 lekë për detyrime kontraktore në zbatimin e punimeve civile, si dhe në të ardhmen të sigurojnë paraprakisht në buxhet burimet e nevojshme për sigurimin e kësaj pagese, për të shmangur kostot e panevojshme të zbatimit të projekteve me financime të huaja.

Brenda tremujorit të dytë 2014

20. Njësia e Zbatimit të Projekteve, të marrë masa për të siguruar fondet nga Bashkia e Tiranës, për të likuiduar Ministrinë e Financës në cilësinë e huamarrësit të kredisë, detyrimet të papaguara në vlerën 1,534,860 euro, përkatësisht në shumën 109,101 euro për detyrimin e normës së interesit dhe komisionit të angazhimit dhe në shumën 1,425,759 euro për pagesat e principialit të kredisë, për arsye se nuk janë përmbushur detyrimet nga zbatimi i marrëveshjes së nënhuasë.

Menjëherë

21. Njësia e Zbatimit të Projekteve, të marrë masa për të rillogaritur koston totale të projektit, duke shtuar detyrimet që kanë lindur për pagesat e kredisë që kanë vazhduar përtej afatit të përcaktuar në marrëveshjen e huasë, në shumën 49,150 euro, për detyrimin e tarifës së angazhimit për fondet e padisbursuara të kredisë, për periudhën 31.12.2008 deri në 6-mujorin e parë 2013.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës prej **207,600 lekë**, për karburantin e konsumuar pa dokumente justifikuese gjatë vitit 2011, e cila përbën dëm ekonomik.

2. Të arkëtohet në organet tatimore shuma prej **19,664 euro**, të tatimit në burim të mbajtur nga pagesat e kontraktorit [REDAKTUAR] e cila është gjendje në llogarinë bankare të projektit dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

3. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit vlera prej **2,788 euro**, përfituar padrejtësisht nga kontraktori [REDAKTUAR] të cilat përbëjnë dëm ekonomik dhe kanë rritur koston e projektit.

4. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe të arkëtohet në organet tatimore shuma prej **34,267 euro**, shkaktuar nga mos mbajtja e tatimit në burim për kontraktorin [REDAKTUAR] e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

D. MASA DISIPLINORE

I. Bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 37, kërkojmë nga Bashkia Tiranë të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

“Larqim nga detyra” për:

1. [REDAKTUAR] me detyrë specialist i prokurimeve, pasi:

- në fushën e prokurimeve, nuk ka paraqitur planin e prokurimeve, në kundërshtim me paragrafin 3.6 të Rregullave dhe politikave të prokurimit të BERZH;
- sipas Raporte progresive për ecurinë të zbatimit të kontratës “Qendra e Trafikut urban”, rezultojnë mosrealizime të grafikut të punimeve, duke sjellë pasoja në afatin e përfundimit;
- gjatë zbatimit të kontratës së konsulencës “Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe tenderimi për Qendrën e Trafikut Urban”, janë dorëzuar raportet me vonesë dhe jo sipas strukturës së përmbajtjes përcaktuar në kushtet kontraktore;
- në zbatimin e kontratës së shërbimit të konsulencës “Programi i përmirësimit të kredidhënies Tiranë” janë dorëzuar me vonesë raportet e përcaktuara në kontratë e nuk janë të strukturuar sipas kontratës, si dhe nuk janë shqyrtuar dhe miratuar nga Komiteti Drejtues;
- nuk ka monitoruar siç duhet zbatimin e kontratës për shërbime të konsulencës, me objekt përgatitjen e detajuar të Strategjisë përfundimtare të qëndrueshmërisë së transportit, pasi amendimi është bërë pas 8 muaj aktivitet shërbime konsulence, dhe raportet janë dorëzuar me vonesë;
- në fushën e blerjeve me vlera të vogla, nuk ka planifikuar në fillim të vitit natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen, për periudhën nga fillimi i projektit deri në vitin 2011, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” pika 2, shkronja (a), kreu VI;

- në procedurën e prokurimit “tender i hapur” për auditimin e pasqyrave financiare, të vitit 2010, me fond limit 1,333,300 lekë, në kërkesat për kapacitetin ekonomik dhe financiar është vendosur kriteri i xhiros mesatare vjetore, mbi dyfishin e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 1, kreu VI, pika 1, shkronja (d), duke kufizuar numrin e pjesëmarrësve.

2. Zj., me detyrë financiare e projektit, pasi:

- ka kryer veprimet e pagesave me bankë për shpenzimet operative, pa urdhër të titullarit të njësisë së zbatimit të projektit;
 - ka lejuar marrjen në dorëzim nga ana e titullarit të projektit të gjithë sasisë së karburantit të blerë për nevojat vjetore që në fillim të vitit;
 - janë paguar në kundërshtim me kushtet e kontratës së konsulencës në shumën 2,788 euro, të cilat kanë rritur koston e projektit;
 - nuk janë kryer veprimet për arkëtimin e tatimit në burim në shumën 19,664 euro, të mbajtur në llogari nga pagesat për kontraktorin [REDAKTUAR] Itali;
 - nuk janë bërë ndalesat dhe nuk është arkëtuar tatimi në burim në shumën 34,267 euro, për kontraktorin [REDAKTUAR] Itali, duke shkaktuar dëm ekonomik në të ardhurat tatimore;
- Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 4, pika 9, si dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.01.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6, paragrafi I.

3. Zj. [REDAKTUAR] me detyrë financiare e projektit, pasi:

- janë kryer veprime të pagesave me bankë për shpenzimet operative, pa urdhër të titullarit të njësisë së zbatimit të projektit;
- janë bërë dalje nga magazina e projektit e gjithë sasia e karburantit të blerë që në fillim të vitit dhe jo sipas nevojave mujore;
- janë paguar në kundërshtim me kushtet e kontratës për konsulentin “Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe tenderimi për Qendrën e Trafikut Urban”, në shumën 2,787 euro, të cilat kanë rritur koston e projektit;
- nuk janë kryer veprimet për arkëtimin në degën e tatimeve në Tiranë, në përputhje me legjislacionin fiskal, të tatimit në burim në shumën 19,664 euro, të mbajtur nga pagesat për kontraktorin [REDAKTUAR] Itali, shumë e cila është gjendje në llogarinë bankare të projektit;
- nuk janë bërë ndalesat dhe nuk janë arkëtuar në Degën e Tatimeve, tatimi në burim në shumën 34,267 euro, për kontraktorin [REDAKTUAR] Itali, duke shkaktuar dëm ekonomik në të ardhurat tatimore.

Këto veprime bien ndesh me nenin 4, pika 9, të ligjit nr. 10296, datë 8.01.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe me nenin 6, paragrafi I, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

“Vërejtje me paralajmërim”, për:

1. Zj. [REDAKTUAR] me detyrë drejtore e projektit “Zhvillimi i rrugëve bashkiake”, pasi:

- nuk ka paraqitur raporte tremujore pranë BERZH, në lidhje me ecurinë e zbatimit të projektit, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në marrëveshje
- nuk ka ndjekur dhe monitoruar siç duhet ecurinë e disbursimeve, pasi është shtyrë disa herë afati i përfundimit të projektit;

- nuk janë programuar dhe shlyer detyrimet për TVSH në shumën 1,005,750 lekë, të lindura nga detyrimet kontraktore për zbatimin e projektit;
- nuk janë përcaktuar rregulla dhe procedura të qarta për menaxhimin e aktiveve dhe ndarjen e funksioneve për stafin, sipas ligjit nr 10296, datë 8.01.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- nuk është xhiruar detyrimi për tatimin në burim në shumën 19,664 euro, i mbajtur për kontraktorin [REDAKTUAR], Itali;
- nuk i janë likuiduar Ministrisë së Financave, detyrimet për tarifën e angazhimit në shumën 49,150 euro, për periudhën 31.12.2008 deri në 6-mujorin e parë 2013;
- nuk është zbatuar Urdhri i Brendshëm i Bashkisë së Tiranës, me nr. 1473, datë 26.11.2008, pika 3, mbi dorëzimin e dokumentacionit tekniko ligjor të objekteve, për kalimin në përdorim të objekteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Punëtorëve të Qytetit, nr. 2;
- në zbatimin e Kontratës së konsulencës “Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe tenderimi për Qendrën e Trafikut Urban”, janë dorëzuar me vonesë raportet dhe jo sipas strukturës së përmbajtjes përcaktuar në kushtet kontraktore, si dhe janë kryer pagesa të padrejta në shumën 2,787 euro;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien ndesh me ligjin nr. 9589, datë 25.07.2006, “Marrëveshje e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe BERZH-it, për financimin e projektit “Zhvillimi i rrugëve në Bashkinë e Tiranës”.

II. Bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 37, propozohet masa disiplinore:

“Largim nga detyra” për:

1. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish Drejtorit të Njesisë së Zbatimit të Projektit,
 2. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish financierit të projektit,
 3. Zj. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish financieres së projektit, për arsye se:
 - gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit, janë konstatuar përgjegjësi të natyrës drejtuese dhe manaxhuese.
- Meqenëse personat e sipërpërmendur kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Njësinë e Zbatimit të Projektit, si dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimit të tyre, **për masën e largimit nga detyra të njoftohet Departamenti i Administratës Publike.**

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Gjovalin Preçi, Luljeta Shtylla, Ina Sokoli, Yllka Pulashi, Rustem Tare, më tej u shqyrtua nga k/auditues Bashkim Arizaj, Drejtori i Departamentit Xhafer Xhorxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT